



HAL
open science

”Një dorë manushaqe të egra për mendime të thella në studimet shqiptare”

Arbnora Dushi

► **To cite this version:**

Arbnora Dushi. ”Një dorë manushaqe të egra për mendime të thella në studimet shqiptare”. Gjurmime Albanologjike: Folklor dhe Etnologji, 2020, 50, pp.333-335. halshs-03300026

HAL Id: halshs-03300026

<https://shs.hal.science/halshs-03300026v1>

Submitted on 16 Aug 2021

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L’archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d’enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

“NJË DORË MANUSHAQE TË EGRA PËR MENDIME
TË THELLA NË STUDIMET SHQIPTARË”

Recension për librin “*Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri*” të autorit Albert Doja, botues: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2018, 373 faqe.



Viteve të fundit një praktikë e bartur nga studimet ndërkombëtare, ka filluar të zërë vend edhe në studimet tona. Është fjala për praktikën e, ta quaj një forme të antologjisë disiplinare autoriale, që i nënkupton botimet festive ku tubohen artikujt të zgjedhur të autorit akademik, me rastin e arritjes së një jubileu të moshës apo të një faze krijuese. Falë kësaj praktike të mirë, vetë-reflektuese për autorin por shumë lehtësuese dhe ndihmuese për lexuesin, i cili arrin t’i ketë të tubuara në një libër tërësinë e veprave të një shkencëtarit, hulumtuesve e studiuesve shqiptarë të shkencave sociale iu ofrua një botim serioz dhe shumë i vlershëm nga një studiues i antropologjisë, artikujt e të cilin janë të botuar e të njohur në pothuajse secilin universitet e qerthull antropologjie në Evropë dhe jo vetëm. Është fjala për antropologun shqiptar Albert Doja dhe botimin e tij të

fundit në gjuhën shqipe me titull “Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri”, ku janë përmbledhur shkrimet e zgjedhura të autorit me rastin e 60 vjetorit të lindjes, nën përkujdesjen e studiueses Enika Abazi, të cilin e botoi Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Libri përbëhet nga artikujt të autorit, shumë prej tyre të botuar më parë në publikime ndërkombëtare në gjuhën frënge e angleze, por që këtu vijnë të përkthyer në shqip. Janë të grupuar në tri kategori konceptuale: *Ftesë në terren*; *Këndvështrime* dhe *Persiatje nga rezervati albanologjik*, ku janë tubuar artikujt e autorit të botuar më parë por edhe nga pjesëmarrjet në konferenca, krahas viteve të shënuara në fund të artikujve.

Në artikullin paraprijës të këtij libri, nga ku edhe morëm shkas ta titullojmë këtë recension, Enika Abazi për Albert Dojen shkruan se “ai u formua si antropolog në laboratorin e themeluar nga Lévi-Strauss në Shkollën e Studimeve të Avancuara në shkencat Sociale në Paris (EHESS), ku i përfundoi me sukses studimet e

doktoratës në antropologji sociale” (f.6). Më pas angazhimet e tij afatgjata në universitete evropiane por edhe pjesëmarrjet në konferenca ndër-kombëtare, krahas kërkesës dhe sfidës së vazhdueshme për arritje në fushën e antropologjisë sociale e kulturore, në njërën anë, por edhe njohjes dhe përcjelljes së hapave të zhvillimit të kësaj shkence, apo atyre paraprijëse si etnografia e folkloristika në Shqipëri, në anën tjetër, i dhanë këtij studiuesi profilin e një shkencëtari të kalibrit ndërkombëtar, por duke mos e lënë të shkëputet asnjëherë nga ndjeshmëria dhe dëshira për ta përparuar këtë shkencë në vendin e tij të origjinës. Pozicioni i tij prej një shkencëtari të brendshëm /të jashtëm do të reflektojë në hulumtimet e tij duke e bërë kështu autor të artikujve mbi dallimet dhe sfidat që në antropologji prodhojnë këndvështrimet vendas/i huaj. Në këtë libër këta artikuj përfshihen në triptikun “Këndvështrime” ku ato shpërfaqen nëpërmjet tri këndvështrimeve: *nga të huajt; nga vendasit dhe nga komunistët*. Në të tri pozicionet këndvështrimore, të identifikuar si projekti kolonialist, karakteri etnofolklorik dhe projekti totalitarist, nëpërmjet një qasjeje analitike, plot me fakte e argumente, të pasuara me refleksione shumë të logjikshme të autorit, jepen, krijohen e ndërtohen problematika të shkencave albanologjike, respektivisht dijeve mbi kulturën popullore, shpirtërore, gojore e materiale, në tërë korpusin e tyre historik e historicist, krahas edhe gjendjes aktuale e nivelit akademik që ato përfaqësojnë sot. Një

studim i këtillë për rrugët e zhvillimit të shkencave shoqërore si etnologjia e folkloristika, lindjen e tyre, rrethanat e bërjes e të zhbërjes, me synimin e tyre për t’u identifikuar me antropologjinë, krahas tendencave, intencave por edhe dështimeve apo improvizimeve për këto arritje, në përballje me modelet e shkollave në rajon e në Evropë që autori i ka të njohura nga përvojat e tij direkte, është hera e parë që bëhet në shkencat albanologjike dhe si i tillë është shumë i nevojshëm, madje i domosdoshëm për njohjen e rrugëve të zhvillimit të albanologjisë.

Aq më tepër njohuria e gjerë dhe erudicioni i autorit Doja, i këtij antropologu të profilizuar nga institucione me renome për këtë shkencë, vërehet në kapitullin e parë të titulluar “*Ftesë në terren*” ku ai shpalos dijet e tij krahas informacioneve por edhe mësimëve shumë të nevojshme për hulumtuesit e studiuesit e sotëm shqiptarë, për antropologjinë si shkencë sociale e kulturore, konceptin, objektin, lidhjet me etnografinë, etnologjinë e folklorin sikurse edhe derivimin prej tyre, krahas edhe dallimeve. Në këtë kontekst, duke i vënë përballë konceptet e etnografisë, etnologjisë e folkloristikës (edhe shqiptare) krahas njohjes së koncepteve moderne të folklorit të pranuar si folklor i gjallë, të përmbledhur gjerësisht dhe qartë në studimin e M. Sims dhe M. Stephens, Albert Doja thotë se “më tepër si një dimension i jashtëzakonshëm dhe shumë i rëndësishëm i kulturës, apo si një pjesë tradicionale, jozyrtare dhe joinstitucionale e kulturës (siç e konceptojnë folklorin e

gjallë autoret në librin e tyre), mund të thuhet se folklori i gjallë vjen më afër nocionit antropologjik të kulturës (f. 47). Dhe një koncept i këtillë që çdo herë e më shumë po pranohet në shkollat e folkloristikës moderne, i thënë edhe nga studiuesi Doja, është inkurajues për hapat e mëtejme të folkloristikës shqiptare, sidomos në Kosovë, ku po bëhen përpjekje të avancimit të kësaj disipline, pavarësisht një trashëgimie konceptesh të ngurta. Për dallim nga Tirana ku folkloristika çdo herë e më shumë po shkrihet në antropologji, në Prishtinë ajo vazhdon ta ruajë emrin e vet, duke provuar t'i avancojë konceptet bashkë me definicionin. Dhe këtë prof. Doja e ka vërejtur dhe vlerësuar.

Kapitulli i tretë e këtij libri i titulluar "Persiatje nga rezervati albanologjik" ku janë të grupuara pjesa më e madhe e artikujve të prof. Dojës ka të bëjë me tema specifike si etniciteti, feja, bektashizmi, kufijtë apo vlerat morale si nderi e besa e ato fetare si besimi. Nëpërmjet rishqyrtimit të tezave të dhëna në botime të ndryshme nga autorë shqiptarë e të huaj, ashtu sikur edhe risjelljes në skenë të faktorëve kulturorë, historikë, e hapësinorë, shumë dukuri të stereotipizuara tashmë, studiuesi Doja i konteston, duke sjellë argumente të cilat japin të tjera rezultate. E këtillë është p.sh. teza për paraqitjen e shoqërisë shqiptare si patriarkale e të prapambetur, të cilën ai e vlerëson se rrënjët i ka në ideologjinë komuniste e cila për të legjitimuar doktrinën e luftës kundër zakoneve të vjetra e fuqizonte tezën e shoqërisë së

prapambetur e patriarkale. Gjithashtu, Doja ndërton tezën e politizimit të fesë për motive riidentifikimi të shqiptarëve duke i vënë përballë argumentet historike, ekonomike, etnografike, regjionale të cilat kanë ndikuar në konvertimin fetar të shqiptarëve. Për Bektashizmin dhe praninë e tij ndër shqiptarë, mbi një bazament të pasur teorik, por edhe praktik nga përvoja në terren, sjell analiza të cilat janë të domosdoshme për studimet mbi etnicitetin e nacionalizmin. Duke qenë në përcjellje të vazhdueshme të botimeve mbi shqiptarët, krahas edhe rrjedhave të zhvillimeve në shoqëri, artikujt e fundit marrin për bazë botimet e antropologëve Ger Duijzings ("Religion and the politics of identity in Kosovo" (London: Hurst, 2000) e Emile Benveniste ("La vocabulaire des institutions indo-européennes: 1.Économie parenté, société, 2. Pounvoir, droit, religion, 2. Vols. (Paris: Minuit, 1969), për të sjellë e risjellë argumente, nëpërmjet referencave të pasura teorike, për çështjet etnografike e politike në Kosovë, apo ato si nderi, morali e besa ndër shqiptarë.

Çështjet e trajtuara në këtë libër nga antropologu Albert Doja, nëpërmjet një qasje thellësisht analitike dhe me një përgatitje të lartë teorike e njohëse, sjellin këndvështrime të reja në studimet shqiptare të cilat janë shumë të nevojshme për mendimin antropologjik shqiptar, prandaj janë të domosdoshme për t'u njohur dhe konsideruar nga hulumtuesit e lexuesit.

Arbnora DUSHI